VENDIM
Nr.50, datë 5.7.2010

PËR NDRYSHIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "SAROLLI" SHPK ME SERI PV03P, NR.07, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.15, DATË 27.8.2003

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës 2.3 të licencës për prodhimin e energjisë elektrike" , neneve 10 dhe 15 pika 4 germat "a" dhe "b" të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 5.07.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë "SAROLLI" sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr.07, seria PV03P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.15, datë 27.08.2003 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga rregullorja "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave",

VENDOSI:

1.Ndryshimin e licencës me seri PV03P, nr.07, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.15, datë 27.08.2003, të mbajtur nga shoqëria "SAROLLI" sh.p.k.

2.Fuqia e instaluar e HEC Shpelle bëhet 400 kW.

3.Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta